



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING			
Nivelo Org. Org. Jëmbështetja Org. Uniti	M-01	Nr. Prot. Proj. Prot. Prot. No.	2197/26
Nr. i Inspeksionit Inspeksionit No. pages	03	Data: Datums: Date:	28.04.26
PRISHTINË/A			

Prishtinë, 28.04.2026

Ministrja e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 93 paragrafit 4 të Kushtetutës së Kosovës, në përputhje me nenin 11 nënparagrafi 1.5 i Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 34/2022), të nenit 10 dhe 11 i Ligjit Nr. 06/L-113 Për Organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.7/2019), nenin 17 i Rregullores Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, të dispozitave të Ligjit Nr.08/L-012 Për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.1/2022) dhe të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2012), nxjerrë këtë:

Qarkore informative nr.01/2026

Për: Sekretarin e Përgjithshëm, Kryetarët e Komunave, Ministrinë përkatëse, KRPP-në, Drejtoritë e Urbanizmit, Odat Profesionale.

Qëllimi: Njoftim mbi obligimin e licencimit të profesionistëve në fushën e ndërtimit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, ju njofton si vijon:

Në bazë të këtij ligji, ushtrimi i profesionit të arkitektit dhe inxhinierit në fushën e ndërtimit lejohet vetëm për personat e licencuar nga Odat përkatëse (neni 23), ndërsa Odat kanë autoritet publik për licencimin dhe mbikëqyrjen e ushtrimit të profesionit (neni 6).

Po ashtu, sipas përkufizimeve ligjore, arkitekt i licencuar është person i licencuar për ushtrimin e profesionit të arkitektit (neni 3, paragrafi 1.7), ndërsa inxhinier i licencuar përfshin të gjitha profilet e inxhinierisë që veprojnë në fushën e ndërtimit (neni 3, paragrafi 1.8).

Fusha e ndërtimit përfshin projektimin, ndërtimin, mbikëqyrjen si dhe aktivitetet e tjera përkatëse (neni 3, paragrafi 1.17), duke i dhënë Odave kompetencë të përfshijnë edhe drejtime të tjera inxhinierike që janë pjesë e kësaj fushe.

Baza në Ligjin e Ndërtimit dhe aktet nënligjore

Në këtë kuadër, theksohet se koncepti i profesionistëve të licencuar është i sanksionuar edhe në Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110, i cili në Nenin 3, pika 1.22 e përcakton “projektuesin” si person profesional të licencuar (arkitekt dhe inxhinier në fushën e ndërtimit), duke vendosur parimin themelor që aktivitetet profesionale në ndërtim mund të ushtrohen vetëm nga persona të kualifikuar dhe të licencuar.

Ky parim është konkretizuar dhe operacionalizuar më tej përmes:

- **Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2017** për procedurat e lejes ndërtimore kategoria I dhe II, i cili përcakton përmbajtjen e dokumentacionit teknik dhe obligimin që ai të hartohet nga profesionistë të licencuar;
- **Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2019**, për procedurat e lejes ndërtimore kategoria III, i cili përcakton përmbajtjen e dokumentacionit teknik dhe obligimin që ai të hartohet nga profesionistë të licencuar;
- **Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2017** për mbikëqyrjen inspektive në ndërtim, i cili rregullon kontrollin e zbatimit të punimeve dhe rolin e profesionistëve të licencuar në këtë proces;
- **Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2013**, i cili përcakton kërkesat teknike dhe procedurat shtesë në procesin ndërtimor dhe tregon rolin e inxhinierëve të licencuar.

Ndërkohë, Ligji Nr. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit e ka avancuar këtë parim duke e rregulluar në mënyrë të plotë sistemin e licencimit dhe duke përcaktuar qartë kompetencat institucionale për lëshimin e licencave.

Funksionalizimi i plotë i sistemit të licencimit

Bazuar në njoftimin zyrtar të MMPH-së me nr. protokollit 871/24, datë 18.02.2025 (bashkangjitur), periudha kalimtare për funksionalizimin e Odave ka përfunduar më 30 maj 2025.

Në këtë kontekst, nga data 1 qershor 2025, në Republikën e Kosovës:

- çdo shërbim profesional në fushën e ndërtimit duhet të kryhet ekskluzivisht nga arkitektë dhe inxhinierë të licencuar;
- çdo dokumentacion teknik (projektim, mbikëqyrje, ekspertizë, implementim, pranime teknike, etj.) duhet të jetë i përpiluar dhe i nënshkruar nga profesionistë të licencuar;
- ndalohet ushtrimi i çfarëdo veprimtarie profesionale në fushën e ndërtimit nga arkitektë apo inxhinierë të palicencuar.

Obligimet për institucionet dhe organizatat

Në përputhje me këtë obligim ligjor, kërkohet nga të gjitha institucionet publike, autoritetet kontraktuese, ndërmarrjet publike dhe organizatat që veprojnë në Republikën e Kosovës që:

- të pranojnë vetëm dokumentacion të nënshkruar nga arkitektë dhe inxhinierë të licencuar;
- të verifikojnë vlefshmërinë e licencave në regjistrat zyrtarë të Odave (neni 24);
- të sigurojnë që në procedurat e prokurimit dhe në zbatimin e projekteve të angazhohen vetëm arkitektë dhe inxhinierë të licencuar;
- të mos lejojnë në asnjë rrethanë përfshirjen e profesionistëve të palicencuar në procese profesionale në fushën e ndërtimit.

Përgjegjësia ligjore

Mosrespektimi i këtyre dispozitave përbën shkelje të:

- Ligjit Nr. 08/L-012;
- Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110;
- si dhe akteve nënligjore përkatëse;

dhe cenon drejtpërdrejt sigurinë publike, cilësinë e ndërtimit dhe përgjegjësinë profesionale, duke qenë bazë për masa administrative dhe ligjore ndaj institucioneve dhe individëve përgjegjës.

Monitorimi i zbatimit

MMPH, në bashkëpunim me Odën e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës dhe Odën e Arkitektëve të Kosovës, do të monitorojë zbatimin e këtij obligimi ligjor në të gjitha nivelet institucionale.

Kësaj Qarkore informative i bashkëngjitet Njoftimi nga Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së me nr. Protokolli 871/24 nga data 18.02.2025.



Qarkorja i dergohet:

- Sekretari i Përgjithshëm;
- Kyetarëve të Komunave të R. së Kosovës;
- Ministrive përkatëse të R.së Kosovës;
- Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik;
- Drejtoritë përkatëse të Urbanizmit;
- Zyrat përkatëse të Prokurimit Publik;
- Kryetarit të Odës së Inxhinierëve të R. së Kosovës;
- Kryetarit të Odës së Arkitektëve të R. së Kosovës;
- Divizioni për Komunikim Publik;
- Arkivi i MMPH-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org. Institute:	SP-02
No. i faqeve Pr. Stranica No. Pages:	01
No. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	871/24
Data: Datum: Date:	18.02.25
PRISHTINË / A	
No. 1	

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of Generaly Secretary

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCË:	
PËR/ZA/TO:	Kryetarët e Komunave të Republikës së Kosovës Ministritë e Republikës së Kosovës Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik Drejtoritë përkatëse të Urbanizmit Zyrat përkatëse të Prokurimit Publik
CC:	Kryetari i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës Kryetari i Odës së Arkitektëve të Republikës së Kosovës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Liburn Aliu, Ministër i MMPHI-së
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, U.D. Sekretar i Përgjithshëm të MMPHI-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Njoftim

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, ka themeluar Odën e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës dhe Odën e Arkitektëve të Republikës së Kosovës. Pas themelimit të Odave, MMPHI është duke ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për funksionalizimin e plotë të këtyre Odave sipas obligimeve ligjore të parapara në legjislacionin në fuqi.

Duke marrë parasysh se Odat janë krijuar për herë të parë në vendin tonë, organizimi dhe funksionalizimi i tyre kërkon kohë dhe një proces të mirë koordinuar. MMPHI është e angazhuar në mënyrë aktive për të siguruar një kalim të rregullt të kompetencave dhe një tranzicion të lehtësuar për të gjithë profesionistët e fushës së ndërtimit.

Bazuar në Ligjin përkatës në fuqi, procesi i licencimit nga MMPHI ka përfunduar me themelimin e Odave, dhe tashmë licencimi i profesionistëve do të kryhet nga Odat e themeluara.

Në këtë kontekst, kërkojmë nga institucionet përkatëse që, deri në funksionalizimin e plotë të Odave, të vazhdojnë të zbatojnë praktikat ekzistuese për ushtrimin e profesionit të arkitektit dhe inxhinierit. Kjo periudhë tranzitore do të zgjasë deri më dt. 30 maj 2025, ose deri në një njoftim tjetër nga MMPHI, e cila do të veprojë në koordinim të plotë me Odat.

Ju falënderojmë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.